



BIENVENUE
WILLKOMMEN
BENVENUTI
WELCOME
BEM-VINDO
BIENVENIDA
MIRË SE VJËN
DOBRODOŠLI
HOŞGELDİNİZ
KU SOO DHOWOW
BUN VENIT
SZERENCSESEN ERKESZTEK
VÍTEJTE
أهلا وسهلا

NEUCHÂTEL

RÉPUBLIQUE ET CANTON DE NEUCHÂTEL
COMMUNES NEUCHÂTELOISES

NEUCHATEL

ALBANAIS | 2020

Mirësevjen në kantonin e Neuchâtel-it



*Mirësevjen në kantonin
e Neuchâtel-it*

BIENVENUE
WILLKOMMEN
BENVENUTI
WELCOME
BEM-VINDO
BIENVENIDA
MIRË SE VJËN
DOBRODOŠLI
HOŞGELDİNİZ
KU SOO DHOWOW
BUN VENIT
SZERENCSESEN ERKESZTEK
VÍTEJTE
اهلا وسهلا

NEUCHÂTEL



Pasqyra e lëndës

FAQET

Mirësevjen në kantonin e Neuchâtel-it	1
Harta e kantonit të Neuchâtel-it	2-3
Informacione të përgjithshme	4
■ Kantoni i Neuchâtel është...	4
■ Nëqoftëse keni nevojë për ndihmë dhe për informata	4
Kontakte informative	5-6
■ Shërbimi i kohezionit multikulturor	5
■ Faqe interneti të dobishme	5
■ Numra urgjence	6
■ Konsultime juridike	6
■ Informacione për shërbimin doganor	6
Sa për dijëni	7-14
■ Lejet e qëndrimit	7
■ E drejta e votës për të huajat dhe të huajt	7
■ Natyralizimi	7
■ Sigurimi shëndetësor	8
■ Tatimet dhe taksat	9
■ Lejet e qarkullimit	10
■ Shkolla	10
■ Përkujdesja parashkollore dhe jashtëshkollore	11
■ Plani i karrierës	11
■ Kërkim i një vëndi pune	11
■ Njohja e kualifikimeve profesionale	12
■ Studimet dhe formimi profesional	12
■ Trajnimi për të rriturit	13
■ Kurse të gjuhës frënge dhe njohuri për Zvicrën dhe kantonin e Neuchâtel-it	14



Mirësevjen në kantonin e Neuchâtel-it

Nëse vini nga një krahinë tjetër e Zvicrës, nga një vënd fqinjë apo nga një horizont akoma më i largët, ne jemi të lumtura dhe të lumtur t'ju mirëpresim.

Neuchâтели ju ofron një kuadër jete me nivel të lartë me liqenin dhe me lartësitë e luginave, me peisazhet e mrekullueshme dhe me natyrën e tij kaq të ruajtur. Në sajë të teknologjisë së përparuar të degëve të industrisë si dhe kompetencave profesionale të punonjësve të tij, ai ka krijuar një famë të lakmueshme. Kudo në botë, një prodhim i Neuchâtel-it është sinonimi i cilësisë.

Kantoni i Neuchâtel-it kultivon shpirtin e hapjes dhe zbaton një politikë ndërkulturore e cila përpiqet për barazi, dinjitet të njëjtë dhe mirëqenie për të gjithë. Shumëllojshmëria e origjinave, besimeve dhe kulturave është një burim pasurie për kantonin dhe për popullsinë e tij.

Nëpërmjet kësaj broshure, ne ju urojmë mirëseardhjen si dhe ju propozojmë disa adresa dhe informacione që mund t'ju shërbejnë.

Duke ju konsideruar si fqinjët e sotëm, shpresojmë që në të ardhmen ju të bëheni mikeshat dhe miqtë tanë.

Qeveria e Republikës dhe Kantonit të Neuchâtel-it.


Gouvernement de la République et canton de Neuchâtel


Grupi i punës për integrimin dhe kohezion multikulturor

Communauté pour l'intégration et la cohésion multiculturelle (CICM)



Harta e kantonit të Neuchâtel-it





Informacione të përgjithshme

KANTONI I NEUCHATELIT ËSHTË...

- Një sipërfaqe prej 803 km².
- Një tërësi popullore prej rreth 176'000 banorësh, që përmban në rradhët e saj një popullsi të huaj të regjistruar prej rreth 45'000 vetash (~25%), e ardhur nga më shumë se 150 vënde të botës.
- Një prej 26 kantoneve dhe gjysmë-kantoneve që përbëjnë Zvicrën. Një kanton ku flitet frëngjishtja.
- E mbi të gjitha, një kanton me traditë mikpritjeje, historia ekonomike, sociale dhe kulturore e të cilit, shpesh është dalluar nga dyndjet e njëpasnjëshme.

NËQOFTËSE KENI NEVOJË PËR NDIHMË DHE PËR INFORMATA

- Adresohuni fillimisht në zyrën e kontrollit të banorëve të komunës tuaj, **është e këshillueshme të paraqiteni personalisht në administratën komunale.**
- Po ashtu, është e mundur të marrësh kontakt në sportelet rajonale sociale (GSR) për çdo kërkesë për përfitime sociale dhe këshilla, ose shërbimin e kohezionit multikulturor (COSM) për këshilla dhe informacione në lidhje me qëndrimin në Zvicër.

Zyra rajonale sociale
Shërbimi i kohezionit multikulturor

www.ne.ch/saso/gsr
www.ne.ch/cosm



Kontakte informative

SHËRBIMI

I KOHEZIONIT MULTIKULTUROR

Shërbimi i kohezionit multikulturor (COSM) është një shërbim i administratës kantonale që ka mandatin të inkurajojë dhe të mbështesë integrimin e njerëzve të vendosur në kanton. Ndër të tjera, ai punon për të nxitur kontaktet dhe mirëkuptimin midis përbërësve të ndryshëm të popullatës nëshatelase. Shërbimi është gjithashtu aktiv për parandalimin e racizmit dhe të diskriminimit, si dhe për këshillimin dhe mbështetjen e projekteve që synojnë integrimin e migrantëve dhe parandalimin e diskriminimeve. Shërbimet e mëposhtme ofrohen veçanërisht:

- Një qendër konsultimi dhe informacioni (këshilla dhe udhëzime, informacione, mbështetje administrative, përkthim me gojë dhe me shkrim, ndërmjetësim, mbështetje) në gjuhë të ndryshme, e hapur për të gjithë, e cila garanton sekretin profesional. Atje do t'ju dëgjojnë dhe këshillojnë njerëz kompetentë që do t'ju mbështesin me mënyrë të plotë për fushat kryesore të jetës në Zvicër (vendbanimi dhe leja, trajnimi, puna, administrata, shëndetësia, etj.). Linjat e këshillimit janë të ofruara në La Chaux-de-Fonds, në Neuchâtel dhe në Fleurier.
- Dëgjimi, mbështetja dhe këshillat do të jenë për këdo që përballet me një situatë raciste ose diskriminuese, goftë viktimë apo dëshmitar.
- Informacione mbi mundësitë e të mësuarit të frëngjishtes.
- Një listë e kurseve të gjuhës dhe kulturës nga vende të ndryshme.
- Një listë e adresave të komuniteteve të huaja në kanton.
- Një rrjet i përkthyesve dhe përkthyesve.

Për të gjitha informatat ose pyetjet:

Shërbimin e kohezionit multikulturor
(Service de la cohésion multiculturelle, COSM)
 Place de la Gare 6 , 2300 La Chaux-de-Fonds,

032 889 74 42

www.ne.ch/cosm

FAQE

INTERNETI TË DOBISHME

- Faqja internet e Shtetit të Neuchâtelit propozon informata të nevojshme, ashtu si dhe lidhje me qytetet, komunat dhe Konfederatën: www.ne.ch
- Faqet www.ne.ch/migrationsetintegration do t'ju informojë më imtësisht mbi problemet e emigracionit, integrimit dhe natyralizimit.
- Siti i Sekretariatit të Shtetit për emigrimin (SEM): www.sem.admin.ch do t'ju ofrojë informata mbi çështjet e emigracionit, integrimit dhe natyralizimit në nivel federal.



Kontakte informative

NUMRA URGJENCE

Policia	117
Zjarrfikësit	118
Ndihma e shpejtë rrugore	140
Përkrahja në rast nevoje	143
Ambulanca	144
Helmimet	145

KONSULTIME JURIDIKE

Rue des Beaux-Arts 11, kati i 1-rë (të mërkurën nga ora 16.00 deri më 19.00)
2000 **Neuchâtel**

www.oan.ch

Rue du Rocher 1 (të enjten nga ora 16.00 deri 19.00)
2300 **La Chaux-de-Fonds**

www.oan.ch

Një opinion gojor si dhe një këshillë për procedurën që duhet ndjekur jepet nga një avokat, i cili vepron në baza vullnetare. Për të mbuluar shpenzimet administrative kërkohet një pagesë prej 30. - frangash. Njerëzit priten pa takim, sipas rradhës së mbërritjes.

INFORMACIONE PËR SHËRBIMIN DOGANOR

Ky shërbim ofron informacione për të gjitha pyetjet në lidhje me lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve në Evropë:

Shërbimi i Informacioneve Doganore (Francë)
0811 20 44 44 (metropol)
+33 1 72 40 78 50 (jashtë metropolit)

www.douane.gouv.fr

Qendra e informacionit doganor (Zvicër) +41 58 467 15 15



Sa për dijeni

LEJET E QËNDRIMIT

Ju mund të merrni informacione lidhur me lejet e qëndrimit nga komuna juaj e banimit ose nga:

Shërbimi i Migracionit
(**Service des migrations**)
Rue de Tivoli 28
2003 Neuchâtel

032 889 63 10
www.ne.ch/smig

Shërbimi i Kohezionit Multikulturor (COSM) është gjithashtu në dispozicionin tuaj për çdo informacion lidhur me llojet e ndryshme të autorizimit të qëndrimit dhe të vendosjes.

E DREJTA E VOTËS PËR TË HUAJAT DHE TË HUAJT

Të vendosesh në kantonin e Neuchâtel-it do të thotë që të përfshihesh konkretisht në jetën e shoqërisë, duke marrë pjesë në jetën politike ose edhe më shumë, të demonstrosh antarësim të plotë duke fituar kombësinë zvicerane.

Sot, të huajt me leje të përhershme qëndrimi (leje C) dhe mbi moshën 18 vjeç munden:

- të votojnë dhe të zgjidhen në rang komunal, për afërsisht pas një viti qëndrimi në kanton.
- të votojnë në rang kantonial pas për afërsisht 5 vjet qëndrimi në kanton.

Për të gjitha informatat, mund të adresoheni në komunën tuaj të banimit.

NATYRALIZIMI

Shtetësia zvicerane fitohet nga prejardhja dhe nga adoptimi (marrja me ligj) ose natyralizimi (marrja me vendim të autoriteteve). Një gjë e tillë është një hap i rëndësishëm për tu integruar plotësisht në jetën e vëndit. Ligji parashikon dy procedura:

- Natyralizimi i thjeshtëzuar është kryesisht për ata që janë martuar me shtetas zviceranë, por në të njëjtën kohë, ligji parashikon edhe raste të tjera specifike. Natyralizimi i thjeshtëzuar është nën përgjegjësinë e Sekretariatit Shtetëror për Migrim (SEM), i cili vendos vetëm për dhënien ose refuzimin e tij.



Sa për dijeni

- Natyralizimi i zakonshëm është një procedurë që duhet të ndiqet nga çdo person i interesuar për të fituar shtetësinë zvicerane, i cili përmbush kushtet që parashikon ligji, si dhe për ata që janë të lidhur nëpërmjet një partneriteti të regjistruar me një person me shtetësi zvicerane. Për të aplikuar për natyralizimin e zakonshëm, duhet të keni, së pari, një leje qëndrimi të përhershme (leje C), e cila ju ka mundësuar të vendoseni dhe të qëndroni në Zvicër për një periudhë kohore prej dhjetë vjetësh në total me një leje qëndrimi konstante, duke përfshirë 3 nga 5 vitet para aplikimit dhe të keni qëndruar në kantonin e Neuchâtel-it për dy vjet rradhazi. Vitet e kaluara në Zvicër, midis moshës 8 dhe 18 vjeç, llogariten dyfish, por në të gjitha rastet qëndrimi efektiv duhet të zgjasë të paktën 6 vjet. Për partneritetin e regjistruar, kërkohet një qëndrim prej 5 vjetësh në total duke përfshirë edhe vitin para aplikimit si dhe 3 vjet në partneritet të regjistruar. Për më tepër, kohëzgjatja e qëndrimit të kaluar me statusin e azilkërkuesit (leja N) ose e studentit nuk merret parasysh. Vetëm gjysma e gjatësisë së qëndrimit të kaluar me një leje F (pranim i përkohshëm) merret parasysh.

Ligji përcakton edhe kritere të tjera dhe parashikon raste të shumta. Procedura administrative për natyralizim mund të zgjasë deri në dy vjet.

Informacione:

- në komunën tuaj të banimit
- në Departamentin e drejtësisë – sektori i natyralizimeve
(Service de la justice - secteur des naturalisations)
Rue de Tivoli 22, 2000 **Neuchâtel**
- në Shërbimin e kohezionit multikulturor
(Service de la cohésion multiculturelle)
Place de la Gare 6, 2300 **La Chaux-de-Fonds**

032 889 41 14

www.ne.ch/naturalisation

032 889 74 42

www.ne.ch/cosm

SIGURIMI SHËNDETËSOR

Sigurimi shëndetësor që mbulon kujdesin mjekësor është i detyrueshëm për të gjithë personat me vendbanim në Zvicër, sipas Ligjit Federal të Sigurimeve Shëndetësore (në tekstin e mëposhtëm: LAMal). Anëtarësimi është një përgjegjësi individuale dhe duhet të bëhet brenda 3 muajve nga marrja e vendbanimit. Nëse asnjë kompani sigurimi nuk e njofton spontanisht antarësimin tuaj brenda kësaj periudhe, zyra e **sigurimit shëndetësor kantonal** (OCAM) do t'ju dërgojë një letër për të njohur emrin e kompanisë së sigurimit LAMal që keni zgjedhur. Pa përgjigje nga ana juaj, zyra e sigurimeve shëndetësore kantonale do të bëjë antarësimin tuaj automatik me një nga siguruesit e njohur prej saj, pa marrë parasysh nivelin e tarifës së tij.

Nëse respektohet afati, antarësimi hyn në fuqi menjëherë pasi të regjistroheni në kontrollin e banimit të komunës tuaj. Në rast të antarësimit të vonuar (pas 3 muajve), sigurimi hyn në fuqi në datën e antarësimit. Kështu, do t'ju duhet të paguani një çmim shtesë. Mundësitë e përjashtimit nga sigurimi shëndetësor ekzistojnë vetëm në raste të caktuara specifike, veçanërisht ato që janë vendosur brenda kornizës së rregulloreve të koordinimit të sigurimeve shoqërore të BE / EFTA.



Sa për dijeni

Sigurimeve u kërkohet të pranojnë kërkesën tuaj për anëtarësim LAMal, pavarësisht nga mosha juaj dhe / ose gjendja e shëndetit (pa pyetësor shëndetësor). Shërbimet e mbuluara nga sigurimi i detyrueshëm janë identike për të gjithë sigurvezit. Para se të merrni një vendim antarësimi pranë një kompanie sigurimi, është e rëndësishme të krahasoni çmimet e kompanive të ndryshme të sigurimit shëndetësor, si dhe format e ndryshme specifike të sigurimit të ofruar (opsioni për franshizën, e cila është shuma e parave që mbetet në ngarkim të të siguruarit, zgjedhja e kufizuar e ofruesit të shërbimit ose sigurim me bonus, etj). Në varësi të metodës së zgjedhur, çmimet ndryshojnë ndjeshëm.

Zyra Kantonale e Sigurimeve Shëndetësore
(Office cantonal de l'assurance-maladie)
 Espace de l'Europe 2
 Case postale 716
 2002 Neuchâtel

032 889 66 30
www.ne.ch/ocam

TATIMET DHE TAKSAT

Të gjithë banorët e kantonit duhet të deklarojnë të ardhurat dhe pasurinë e fituar në Zvicër dhe / ose jashtë saj. Personat me kombësi të huaj që nuk posedojnë leje qëndrimi të përhershme (leje C) i nënshtrohen tatimit mbi burimin. Vini re se njerëzit që plotësojnë këto kritere, por janë të martuar me një shtetas zviceran ose me një posedues të një leje C, nuk i nënshtrohen taksës mbi burimin. Për çdo informacion shtesë, ju mund të konsultoni faqen e internetit të **shërbimit të kontributeve (SCCO)**: www.ne.ch/scco.

Për të ruajtur një treg të shëndetshëm të punës, për të siguruar drejtësi tatimore dhe për të qënë në gjendje t'i ndihmojë ata që kanë nevojë, kantoni i Neuchâtel-it i ka forcuar mjetet e tij të luftës kundër punës së zezë e të paligjshme, mashtrimit fiskal dhe abuzimit ndaj përfitimeve sociale (fushata "Réglo"). Abuzimi ka jo vetëm një efekt negativ në shoqëri, por mund të sjellë, gjithashtu, pasoja dramatike për njerëzit që mashtrojnë:

- Procedura ligjore si edhe penale
- Dobësi për të mbrojtur të drejtat tuaja dhe rrezik për të hyrë në borxh
- Humbjen e lejes së qëndrimit për të huajt
- Reduktim të burimeve financiare për pensionin dhe për rastet e aksidentit www.ne.ch/reglo

Informacion dhe këshilla:

Zona e "Punës së deklaruar": Zyra e marrëdhënieve dhe kushteve të punës (SEMP),
 rue du Parc 117, 2300 La Chaux-de-Fonds, në numrin e telefonit 032 889 68 89.

Zona e "Taksave të paguara": Shërbimi i kontributeve (SCCO),
 rue du Docteur Coullery 5, 2300 La Chaux-de-Fonds, në numrin e telefonit 032 889 77 77.



Sa për dijeni

LEJET E QARKULLIMIT

Lejet e huaja të qarkullimit njihen në Zvicër dhe mund të përdoren vetëm për udhëtime private dhe për një periudhë kohore maksimumi një vit.

Për të vazhduar drejtimin e automjeteve pas një viti ose për të vozitur profesionalisht, duhet bërë ndërrimi i patentës aktuale të shoferit me një licencë zvicerane, pranë **shërbimit kantonial të automjeteve dhe navigimit (SCAN)**.

Procedura e këmbimit është në dispozicion në këtë adresë: www.scan-ne.ch/permisetranger
Kujdes, ajo mund të ndryshojë në varësi të vendit në të cilin keni marrë patentën tuaj dhe kategoritë që dispononi.

SCAN

Secteur admin. conducteurs
Malvilliers
Champs-Corbet 1
2043 **Boudevilliers**

www.scan-ne.ch

SHKOLLA

Të gjithë fëmijët pranohen në shkollat e detyrueshme të kantonit të Neuchâtelit.

Ju mund të merrni informata të nevojshme pranë administratës së komunës tuaj të banimit. Në moshën 4 vjeçare fillon arsimi i detyrueshëm me një afat prej 11 vjetësh. Në përfundim të tij, nxënësi mund të vazhdojë studimet ose të ndjekë arsimin profesional.

Gjatë arsimit të detyrueshëm, fëmija juaj mund të marrë, gjithashtu, kurse në gjuhën dhe kulturën e origjinës të organizuara nga konsullatat ose komunitetet e huaja.

Ju do t'i gjeni të gjitha hollësitë e nevojshme në adresën e mëposhtme:

Shërbimi i arsimit të detyruar
(Service de l'enseignement obligatoire)
Rue de l'Écluse 67
2001 **Neuchâtel**

032 889 69 20

www.ne.ch/seo



Sa për dijeni

PËRKUJDESJA PARASHKOLLORE DHE JASHTËSHKOLLORE

Për të zënë një vend për fëmijën tuaj në strukturat parashkollore (0-4 vjet), regjistrimi duhet të bëhet nëpërmjet listës së pritjes kantonale AEF, pranë **zyrës së strukturave të pritjes jashtë-familjare dhe institucioneve arsimore të specializuara** (OSAE). Regjistrimi duhet të rinovohet çdo 3 muaj, me të dhënat e kontaktit të fëmijës. (Lista e disponueshme në [www.ne.ch/spaj: accueil préscolaire et parascolaire/pour les parents/inscription](http://www.ne.ch/spaj:accueil_prescolaire_et_parascolaire/pour_les_parents/inscription)).

Të gjitha ndryshimet e regjistrimit që kanë të bëjnë me përkujdesjen parashkollore të fëmijëve (ditët e qëndrimit, ndryshimi i adresës, etj.) duhet të dërgohen në këtë zyrë.

Për të zënë një vend në strukturat jashtëshkollore (4 vjet dhe +), regjistrimi duhet të bëhet drejtpërdrejt pranë drejtorisë së strukturës përkatëse ose pranë komunës së vendbanimit.

zyrës së strukturave të pritjes jashtë-familjare dhe institucioneve arsimore të specializuara
(Office des structures d'accueil extrafamilial et des institutions d'éducation spécialisée)

www.ne.ch/spaj

Fbg du Lac 23-25
2000 Neuchâtel

PLANI I KARRIERËS

Qendra e orientimit profesional, universitar dhe e karrierës (OCOSP) ofron mbështetje dhe këshilla për nxënës, të rinj apo të rritur që dëshirojnë të ndërtojnë ose të rindërtojnë të ardhmen e tyre profesionale.

032 889 20 20

www.ne.ch/ocosp

KËRKIM I NJË VËNDI PUNE

Zyrat rajonale të vendosjes (ORP) - Sektori ProEmployés
(Offices régionaux de placement (ORP)- Secteur ProEmployés)
informon dhe inkuadron njerëzit që kërkojnë një vend pune :

www.ne.ch/orp

Zyra **Neuchâtel**
Zyra **La Chaux-de-Fonds**
Zyra **Fleurier**

032 889 68 18

032 889 68 13

032 889 61 50



Sa për dijeni

NJOHJA E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Njohja e diplomave të huaja nga një autoritet është e nevojshme në shumë profesione. Në Zvicër, autoritetet kompetente për njohjen e diplomave ndryshojnë sipas profesionit.

Sekretariati Shtetëror për formacion, për hulumtim dhe inovacion (SEFRI) 058 462 28 26
Pika e kontaktit për njohjen e diplomave dhe kualifikimeve www.sbfi.admin.ch/qualification
profesionale.

Neni 32 i Urdhëresës Federale të formimit profesional u mundëson të rriturive të marrin një certifikatë federale të kapacitetit (CFC) pa stazh, duke u prezantuar lirisht në provimet e përfundimit të praktikës, pasi të kenë ndjekur eventualisht kurset përgatitore, ose duke vërtetuar përvojën e fituar (VAE).

Të interesuarit duhet, së pari, të kontaktojnë zyrën kantonale të orientimit shkollor dhe profesional (OCOSP). www.ne.ch/ocosp

STUDIMET DHE FORMIMI PROFESIONAL

Shërbimi i formimit të pas-detyrueshëm dhe i orientimit
(Service des formations post-obligatoires et de l'orientation, SFPO)
Espacité 1
2300 La Chaux-de-Fonds

032 889 69 40
www.ne.ch/sfpo

Qendra ndërrajonale e formimit profesional të Bjeshkëve të Neuchâtel-it
(Centre interrégional de formation des Montagnes neuchâtelaises, CIFOM)
Rue de la Serre 62
2300 La Chaux-de-Fonds

032 886 30 00
www.cifom.ch

Qendra profesionale e Bregut të Neuchâtelit
(Centre professionnel du Littoral neuchâtelais, CPLN)
Rue de la Maladière 84
2000 Neuchâtel

032 717 40 00
www.cpln.ch

Universiteti
(Université)
Avenue du 1^{er}-Mars 26
2000 Neuchâtel

032 718 10 00
www.unine.ch



Sa për diejini

Qendra profesionale e mjeshtërive të ndërtimit
(Centre professionnel des métiers du bâtiment, CPMB)
 Les Longues-Raies 11
 2013 Colombier

032 843 48 00
www.cpmb.ch

Zyra e bursave
(Office des bourses)
 Espace de l'Europe 2
 2000 Neuchâtel

032 889 69 02
www.ne.ch/bourses

TRAJNIMI PËR TË RRITURIT

Shërbimi i punës
(Service de l'emploi)
 Rue du Parc 119
 2301 La Chaux-de-Fonds

032 889 68 12
www.ne.ch/sempe

Qendra e Neuchâtel-it për integrimin profesional
(Centre neuchâtelois d'intégration professionnelle, CNIP)
 Site Dubied 12
 2108 Couvet

032 889 69 25
www.cnip.ch

Universiteti popullor i Neuchâtel-it
(Université populaire neuchâteloise)
 Rue de la Maladière 84
 2000 Neuchâtel
 Rue de la Serre 62
 2300 La Chaux-de-Fonds

www.cpln.ch/upn
 032 725 50 40

032 886 31 10

OSEO Neuchâtel
 Rue de la Promenade 5
 2105 Travers

032 886 43 84
www.oseo-ne.ch

Shoqata të lexojmë e të shkruajmë
(Association Lire et Ecrire)
 Rue du Doubs 103, 2300 La Chaux-de-Fonds
 Rue Louis-Favre 1, 2000 Neuchâtel

032 914 10 81
www.lire-et-ecrire.ch



Sa për diejni

KURSE TË GJUHËS FRËNGJE DHE NJOHURI PËR ZVICRËN DHE KANTONIN E NEUCHÂTEL-IT

Shërbimi i kohezionit multikulturor (COSM) mundet t'ju informojë dhe t'ju orientojë tek ofertat ekzistuese të kurseve të frëngjishtes, si dhe kurseve të tjera të dobishme (numërimit, TIC, etj.).

Shërbimi propozon, gjithashtu, kurse për të marrë njohuri në lidhje me Zvicrën dhe kantonin e Neuchâtel-it, të tilla si "Programi i Integritimit dhe i njohurive qytetare" (PICC) ose kursi "Të jetosh në Zvicër dhe në Neuchâtel" i destinuar për kandidatët për natyralizim.

Për çdo informacion:

Shërbimi i kohezionit multikulturor
(Service de la cohésion multiculturelle, COSM)
Place de la Gare 6
2300 **La Chaux-de-Fonds**

032 889 74 42
www.ne.ch/cosm







ne.ch

RÉPUBLIQUE ET CANTON DE NEUCHÂTEL

SERVICE DE LA COHÉSION

MULTICULTURELLE

PLACE DE LA GARE 6

2300 LA CHAUX-DE-FONDS

T +41 (0)32 889 74 42

F +41 (0)32 722 04 04

www.ne.ch/migrationsetintegration